

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“D SISTEM FIRE PROTECTION SYSTEMS & ENGINEERING” SHPK**

Ne Tirane, sot me date 3 Janar 2025 , ne cilesine e “ortakut themelues”:

ERION BREGASI, ,i biri i Shkëlqim Bregasi, i ditelindjes. 07.07.1984, lindur ne Kuçovë, Shqiperi dhe banues ne: Yensehir mh. Petek sok. No:3/0 Daire 67 Pendik-Istanbul, Zip Code 34912, Turqi , shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plete jurdike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr. I40704085L

ne cilesite e “ortakut themelues”, me vullnet të lire, të plete e të sinqerte, hartuan kete akt themelimi per krijimin e shoqerise perqjegjesi te kufizuar me emertimin “D SISTEM FIRE PROTECTION SYSTEMS & ENGINEERING” shpk mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare” te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

**KREU I
EMRI, FORMA JURIDIKE, SELI, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

Neni 1
Krijimi

Shoqeria “**D SISTEM FIRE PROTECTION SYSTEMS & ENGINEERING**” shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perqjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Emri tregtar i shoqerise “D SISTEM FIRE PROTECTION SYSTEMS & ENGINEERING”.

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**D SISTEM FIRE PROTECTION SYSTEMS & ENGINEERING**” shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku i shoqerise”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e paslyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Tirane, ne adresen : ZK 2460, nr. Pasurise 217/9-N2, Rr. Muhamet Deliu, Pall. I ri, ngjitur me Bigmarket, kati perdhe. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asambleja se Ortakut

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Qëllimi i kompanisë është :



Ne fushen e sistemeve te zjarrit shoqeria do te kryeje: Studimin, kolaudimin , projektimin, supermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te sistemeve mekanike dhe elektrike te mbrojtjes nga zjarri. Shoqeria do te organizoje trajnime dhe certifikime per sistemet e mbrojtjes nga zjarr. Ne fushen e tregetise shoqeria do te kryeje: Tregtimin dhe import-eksportin me shumice Pakice, te te gjitha mallrave dhe materialeve ne funksion te instalimit dhe mirembajtjes se sistemeve te mbrojtjes nga zjarri per objekte civile, industriale, tregtare, publike.

Neni 5 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II **KAPITALI**

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe do te shlyhet sa po te hapen llogarite bankare te shoqerise teresisht ne te holla nga "ortaku i shoqerise" i shoqerise:

1. **Erion Bregasi** eshte zoterues i 1 kuote me vlore 100,000 leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund te jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaket perqjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund te zvogëlohet me vendim të Asambleja e Ortakut në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet

1. Sipas ketij akti të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a) përcaktimin e politikave tregtare;

b) ndryshime të statutit;

c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administritimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës;

c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;

dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) shpérndarjen e fitimeve vjetore;

ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;

g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;

gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administritimit;

h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;

j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administritimit apo këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqerise eshte Z. Erion Bregasi mbajtes i ID me nr. I40704085L.

Administratoret e shoqerise do te ushtrojnë kompetencat e administritimit per një afat 5 vjear me te drejte riperteritje.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblese se Ortakut te shoqerise.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratorret ka tē drejtë e detyrohet tē:

- a) kryejë tē gjitha veprimet e administrimit tē zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare tē shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, tē vendosura nga Asambleja e Ortakut;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset pér mbajtjen e saktë e tē rregullt tē dokumenteve dhe tē librave kontabël tē shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente pérpara Asambleja e Ortakut pér miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur pér rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj tē dhënat e detyrueshme tē shoqërisë, siç parashikohet në ligjin pér Qendrën Kombëtare tē Regjistrimit;
- e) raportojë pérpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë pér veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar tē thërrasi mbledhjen e Asambleja e Ortakut edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve tē ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve tē para pas regjistrimit tē tij, propozon tē blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 pér qind tē aseteve tē shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare tē certifikuara,

Administratori ka tē drejte tē kryeje tē gjitha veprimet e administrimit tē zakonshëm e tē jashtezakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë pérpara tē gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo tē huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo tē huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrate te tatim taksave, autoriteteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore tē gjitha shkallevet. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me tē tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj tē tretëve kur ajo provon se tē tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur tē tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpalja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj tē tretëve, pér shkelje tē ligjeve, pér shkelje tē statutit, apo pér faje tē kryera gjatë administrimit tē shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve tē pamiratuara nga Asambleja e Ortakut që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, pér tē përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme tē detyrimit tē besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 tē ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) tē kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më tē mirë tē shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje tē veçantë ndikimit tē veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;

- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asambleja e Ortakut, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asambleja e Ortakut vendos rrëth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "**D SISTEM FIRE PROTECTION SYSTEMS & ENGINEERING**" shpk, u redaktua me vullnetin te lire e te plete te "ortakut themelues", ne 2 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe.

ORTAKU I SHOQERISE

ERION BREGASI

Erion Bregasi
